

AKT THEMELIMI
I Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar

KeyStone

Sot, më date 10.03.2025, personalisht:

Pietro Lano, atesia Edoardo, shtetas Italian, lindur me 25.10.2000, ne Torino, Itali dhe banues ne Corso Chieri 145, Torino, Itali, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me pasaporte, me cilesine e ortakut themelues te shoqerise tregtare.

Përpilon këtë akt themelimi të shoqërisë tregtare me termat e mëposhtme:

NENI 1

Të themelojë Shoqërinë Tregtare në formën e një Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar.

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me:

Emri i Shoqerise: KeyStone

Emri tregtar: KeyStone

NENI 2 Qëllimi i krijimit të Shoqërisë.

Qëllimi i krijimit të kësaj Shoqërie është zhvillimi i aktivitetit ekonomik në fusha të ndryshme. Veprimtaria e kësaj Shoqërie do të jetë thellësisht me karakter ekonomik dhe qëllim fitimprurës.

NENI 3 Objekti i veprimtarisë

Shoqëria, në përputhje me dispozitat dhe kufizimet e ligjit, ka për objekt veprimtaritë e mëposhtme:

- Keshillim dhe asistence mbi menaxhimin, planifikimin strategjik dhe organizues, objektivat dhe politikat e marketingut duke përfshirë por pa u kufizuar në menaxhimin dhe promovimin e imazhit dixhital.
- Dhënia me qira dhe funksionimi i pasurive të paluajtshme të veta ose të marra me qira

NENI 4 Selia e Shoqërisë dhe Afati

Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: Rr. Themistokli Germenji, Nr. Pasurie 2/106-N.13, Tirane.

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një periudhe kohore pa afat.

Pietro Lano

NENI 5 Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar është 100.000 (njqind mije) Lek dhe zotërohet nga ortaku themelues.

Vlera totale e kapitalit të regjistruar: 100.000 leke

Vlera e paguar: 100.000 leke

Numri total i kuotave: 1

Kapitali themeltar është mbuluar tërësisht nga ortaku i vetem themelues.

NENI 6

Ortaku themelues i Shoqërisë Tregtare zotëron kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

- Pietro Lano, pjesëmarrja me përqindje 100 %, 1 kuote, lloji i kontributit në para 100.000 leke.
- Kapitali themeltar është mbuluar tërësisht nga ortaku i vetem themelues.

NENI 7 Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Ortaku i Vetem – organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratori/et – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

NENI 8 Administratori

Shoqëria administrohet nga ana e Administratorit i cili zgjidhet për një mandat 5 (pese) vjeçar me të drejtë rizgjedhje. Administratori i parë të shoqërisë do të jenë Z. Pietro Lano

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili i ushtron këto të drejta në përrputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 9

Ortaku mund të vendose me vullnetin e tij, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 10

Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre.



NENI 11

Mosmarrveshjet për themelimin e Shoqërisë zgjidhen me mirekuptim dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

NENI 12

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortaku Themelues u gjet sipas vullnetit të tij dhe u nënshkrua pa vërejtje.

ORTAKU I VETEM THEMELUES

Pietro Lano

Pietro Lano

Pietro Lano